

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

## TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 25 SHTATOR 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,  
ODRŽANE 25. SEPTEMBRA 2003.

Shtator – Septembar  
2003

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e financave publike (2003/25),
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet (2003/26).

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Прво разматрање Нацрта закона о измени и допуни Закона о менаџирању јавним финансијама (2003/25),
3. Прво разматрање Нацрта закона о пестицидима (2003/26).

**AGENDA**

1. Approval of the minutes of previous meeting,
2. First reading of the Draft Law on changing and completing of the Law on Management of Public Finance (2003/25),
3. First reading of the Draft Law on aw on pesticide (2003/26).

# T R A N S K R I P T

## I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR 25 SHTATOR 2003

Seanca Plenare u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal – Prishtinë.

**SEANCËN E KRYESOI, FATMIR SEJDIU, ANËTAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, GOJKO SAVIQ, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi punën në orën 10,15.

**KRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Të nderuar kolegë deputetë, mirëseerdhët në Seancën e sotme.

Sipas informacioneve që kemi nga Sekretaria, ekziston numër i mjaftueshëm i deputetëve në sallë dhe mund të fillojmë me punën.

Siç e keni marrë bashkëngjitur me thirrje, rendi i ditës për mbledhjen e sotme, është:

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për menaxhimin e financave publike, dhe
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pesticidet.

Prezent sot kemi edhe dy nga ministrat e Qeverisë së Kosovës që do të paraqesin ekspozetë për dy projektet, të parin dhe të dytin.

A pajtoheni me këtë rend të ditës?

Piksëpari të them se ekziston një konstatim i përbashkët që jemi pajtuar në seancën e kaluar. Një ndryshim i vogël është bërë në ndërkoħe, në bazë të propozimeve të dhëna atë ditë në seancë. Është fjala për tērheqjen e një shqyrtimi të mëtejshëm të ligjit për shkak se grupet parlamentare, përkatesisht komisionet parlamentare nuk janë bërë të gatshme dhe është futur sipas propozimit po ashtu në seancën e kaluar dhe kjo është një marrëveshje, gjithashtu interne me shumicën e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit. Urdhëroni zotri Luzha.

#### BERAT LUZHA:

Zotëri kryesues, të nderuar deputetë,

Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kemi debatuar për situatën politike në Kosovë, me theks të veçantë për bisedimet e paralajmëruara me Serbinë. Debat u ndërpre, kurse nuk u miratua asnje dokument, madje as konkluzionet nga kjo mbledhje, por ishte kërkosë që të miratohej një deklaratë apo një dokument tjetër.

Në këtë mbledhje, për habi, mungon kryetari i Kuvendit, siç mungojnë edhe kryetarët e grupeve parlamentare kryesore. Konsiderojmë se kemi të bëjmë me ikjen nga përgjegjësia në këtë gjendje shum të vështirë, kurse në emër të Kuvendit mundësohet të flasin njerëz të paautorizuar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike konsideron se Kuvendi duhet ta kryejë detyrën e vet: të miratojë një platformë e cila do t'u shërbejë institucioneve tonë për bisedime. Para se gjithash duhet të mbizotërojë arsyetë te deputetët, në mënyrë që bisedimet t'mos na zënë të papërgatitur dhe pa qëndrime të harmonizuara institucionale. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Vetëm një sqarim. Në seancën e kaluar, ka mbet për obligim që përfundimet nga debati dhe nga ajo pjesë e diskutimeve që i janë bashkëngjitur Sekretarisë dhe Kryesisë së Kuvendit të hartohen apo të nxirren përfundime të caktuara. Besoj se në një nga seancat e ardhshme, s'mund të them në seancën e ardhshme, por - në një nga seanca të ardhshme, adekuat kohës, do të bëhet kjo. Ju falemnderit.

Kalojmë pra në pikën e parë të rendit të ditës – Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja le kaluar.

A ka kush vërejtje?

Ju lutem, zoti Koci, nëse keni çështje substanciale, mund t'i shtroni, s'ka kurrfarë problemi. Nëse ka çështje formale, mund t'i bashkëngjiteni me shkrim dhe Sekretaria do t'i bëjë korrigimet. Urdhëroni. Pastaj zonja Shukriu.

**GANI KOCI:**

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Unë e kuptoj arsyen e Sekretarisë që të mos mund t'përkthejë saktësisht dokumentet dhe shkrimet, ligjet, projektligjet e tjera e tjera e të na vijnë në mënyrë të masakruar, po them me një gjuhë të masakruar, por nuk e kuptoj, absolutisht Sekretarinë e Kuvendit, që edhe dokumentet – fjalimet e shkruara - të mos mund t'i bartë në mënyrë të saktë dhe në mënyrë të drejtë në procesverbal. Kështu ka ndodhur me fjalimin tim, që unë e kam dorëzuar me shkrim javën e kaluar dhe që nuk është futur në procesverbal në mënyrë të saktë dhe në mënyrë origjinale si e kam dorëzuar unë me shkrim.

Sa për ilustrim, po e them se fjalia “rezultat i marrëveshjes politike” që ekziston në fjalimin tim, në procesverbal është dalë “marrëveshje publike” dhe, është dallim shumesencial në mes “marrëveshjes politike” dhe “marrëveshjes publike”. Pastaj, edhe një tjetër. Në vend të fjalës “faji” këta e kanë futur fjalën “fjalë”, gjë që, konsideroj është e papranueshme. Prandaj edhe le të jetë kjo vërejtje e fundit. Bile, nëse s'munden dhe s'dijnë të përkthejnë mirë, le të përshkruajnë dhe le të kopjojnë mirë ato që ne i dorëzojmë me shkrim.

**KRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Të falemnderit. Lus Sekretarinë që të krahasojë tekstin me origjinalin dhe të bëjë korrigjime të nevojshme. Zonja Shukriu...

**EDI SHUKRIU:**

Do të flas për çështje substanciale dhe që po na përsëriten lidhur me procesverebalin dhe transkriptet që po na dorëzohen.

Sa i përket procesverbalit, po më habit se këtu i shoh fjalimet. Në seancën e fundit kemi parë se ka pasur edhe diskutues të tjera. Këtu janë vetëm fjalimet e kryetarëve të grupeve parlamentare, ndërsa ata, të cilët kanë diskutuar – përmenden vetëm me emra. Unë kuptoj se procesverbali s'duhet të jetë i ngarkuar shum, por megjithatë diskutantët e tjerë kanë pasë edhe risi të tjera që është dashur të përfshihen. Në qoftë se diskutimet e të tjerëve nuk përfshihen, do të thotë ne s'kemi nevojë të jemi si deputetë këtu! Parlamenti, mund të punojë vetëm me kryetarët e grupeve parlamentare!? Dhe, po më duket se është e palejueshme, do të thotë, të shkojë i gjithë fjalimi i të tjerëve, ndërsa tjerë diskutantë të mos jenë këtu.

Dhe, pasi e kam marr fjalën, lidhur edhe me transkriptin. Të dyjet, mendoj janë dokumente poaq të rëndësishme për punën e këtij Kuvendi dhe mendoj se askush nuk ka të drejtë ta shtrembërojë historinë. Kjo është histori dhe askush nuk ka të drejtë ta shtrembërojë historinë! Pse e them këtë? Në transkript, të gjithë kemi dëgjuar, nga fjala e kryetarit modifikohen reagimet e kryetarit, gjë që nuk lejohet të bëhet. Natyrisht që nuk më pëlqen fare që kryetari i Parlamentit bën komente pas secilit diskutim. Nën dy...

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, përbajuni vërejtjeve konkrete në procesverbal. Kjo është idea...

#### EDI SHUKRIU:

...Vërejtje konkrete!? Më duhet të ndalem në transkript, sepse edhe ai është dokument dhe - më lejoni. Në transkriptin e fundit, shënohet se dikush ka folur nga vendi dhe nuk është dëgjuar, faqe 38. Në qoftë se dëgjohet, do të thotë ajo shënohet. Kur është diskutuar për ndryshimet në Ligjin për telekomunikacion, kam këruar fjalën nga kryetari, nuk më është dhënë!? Kam këruar disa herë. Kam qenë e detyruar që ta ngris zërin nga vendi. Pastaj, në transkript nuk është shënuar fare çfarë kam thënë! Kam bër vërejtje me shkrim dhe më është përgjigjur se ata që flasin nga vendi nuk shënohen! Çfarë janë këto kritere? Herë shënohet, herë s'shënohet!

Dhe, sa jam këtu, po ashtu është çështje-shumsubstanciale, ju lutem. Në seancat e kaluara iu mohua fjala e njërit prej ministrave se ne diskutonim për amendamentet për ligjin. Kur ishte fjala për Ligjin për telekomunikacion, që bëhen para ligjeve ato modifikimet, si ndodhi atë ditë që iu dha ministrit tjetër fjala dhe, nën ndikimin e tij...

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Zonja Shukriu, u a tërheq vërejtjen. Këto çështje janë jashtë pjesës së bisedës konkrete që duhet të jetë rreth procesverbalit dhe transkriptit. Janë çështje që mund të shtrohen ndonjëherë në ndonjë temë tjeter dhe ju lutem, përmbyajuni dhe përmbyllenit diskutimin.

### EDI SHUKRIU:

U bë. Ju falemnderit shum dhe kërkoj nga të gjithë, në veçanti nga Kryesia dhe kryetari i saj t'i përbahen kritereve dhe Rregullores. Ju falemnderit shum.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. A dëshiron kush tjetër? Urdhëroni edhe ju, zotëri... Deputeti Milovan Jovanoviq.

### MILOVAN JOVANOVIĆ:

Poštovane kolege, poštovani predsedničë!...poštovano Predsedništvo, poštovani ministri.

Evo, mi se i dalje vozimo transportereima, stalno kasnimo, što naravno nije naš posao da organizujemo sve to. Iz tog razloga mi danas, recimo, učestvujemo po prvoj tački dnevnog reda, znači oko zapisnika a zapisnik niko od nas nije ni uzeo, niti pogledao. Na neki način mi smo stalno u takvoj situaciji da dolazimo nepripremljeni i da ne znamo, da ne znamo kakav je dokument formiran i kako je naš rad opisan na prethodnoj sednici. A opet se vračam, uzrok tome je organizacija našeg dolaska ovde a može se izvesti od toga opet da je i politička situacija, politička situacija dovela do toga. Dakle, nemogućnost...

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju lutem, zotëri nëse keni çështje konkrete për procesverbalin.

MILOVAN JOVANOVIĆ:

... ja vračam na politički teren, nemogućnsot da se slobodno krećemo je osnova naših problema ovde u radu. Eto toliko. To je to. Hvala najlepše.

KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Atëherë, ju lus që të vini edhe më herët dhe në mënyrën si vini, dëshira jonë është që të vini të gjithë njësoj dhe ka mundësi të tilla dhe i merrni materialet sikur të gjithë tjerët.

Ju lutem, me kaq përfundojmë. Ju lutem, a jeni që procesverbali, me vërejtjet, ato që qëndrojnë, që të bëhen krahasime normale – të miratohet.

Kush është për? Ju falemnderit.

Konstatoj se Procesverbali i seancës së kaluar u miratua.

Pika e dytë është – Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Ky Projektligj iu është shpërndarë deputetëve më 25 korrik 2003. Janë përbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform Rregullës 31 pika 1.

Ky debat është debat i parë, natyrisht për shqyrtim në parim dhe do të dëshironim të dëgjonim ministrin e ekonomisë dhe financave, zotin Sadriu dhe ta paraqesë ekspozenë e tij para Kuvendit dhe arsyetimet për këtë Projektligj. Urdhëroni, e keni fjalën zoti ministër.

ALI SADRIU:

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, konkretisht nen 44, kufizon huadhënet, huamarjet, kapitalizimet. Duke parë këtë, si komponentë kufizuese dhe duke u nisur nga fakti se në praktikë autoritetet publike po ballafaqohen me vështirësitë financiare, parashtronet nevoja e shqyrtimit të mundësive për të lejuar nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, një autoriteti publik nëse Qeveria dhe PSSP paraprakisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimin e asaj huaje. Praktika e deritanishme e mbështetjes së nevojave vijuese financiare të autoriteteve publike, në këtë rast kompanive publike por edhe tjera, nga grantet e buxhetit duhet të mënjanohet.

Në këtë kontekst jemi në vazhdën e shqyrtimit të mundësive të gjetjes së zgjidhjeve të pranueshme për financimin e veprimtarive vijuese për zhvillimin e këtyre kompanive përmes mënyrave tjera.

Jemi të mendimit se një nga format më të pranueshme të mbështetjes financiare për këtë fazë të zhvillimit do të ishte financimi përmes huave të cilat do të lejoheshin nga mjetet e lira buxhetore.

Me këtë qasje do të kontribuojmë që kompania publike të konsolidohet, aftësohet, që të afarojë me sukses dhe të krijojë profit dhe të jetë në gjendje të servisojë përkatësisht të kthejë kreditë e marrura.

Kjo mënyrë e përkrahjes po shqyrtohet për mbështetjen e KEK-ut si kompani publike, e cila domosdo, në një të ardhme të afërt duhet të ballafaqohet me procesin e ristrukturimit të përgjithshëm. Një fenomen i tillë do të obligonte KEK-un që të menaxhohen mjetet me efikasitet më të lartë ser gjertani. Kurse, nga ana tjetër, paraprakisht, do të obligohej për kthimin e atyre mjeteve.

Kjo formë e plasimit të mjeteve do të mund të përdoreje edhe në rastet tjera të ngjashme për financimin e projekteve të ndryshme zhvillimore kur konstatohet se nuk ka zgjidhje tjetër të mundshme në kuadër të tregut financiar. Kjo do të mund të aplikohet për “Trepçën” apo edhe për rastet tjera kur është e domosdoshme mbështetja financiare, me tendencë që financimet nga grantet buxhetore të evitojen.

Padyshim se për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë, rëndësi të posaçme ka edhe stimulimi i biznisit të vogël dhe të mesëm. Ky sektor i ekonomisë, në fazën e tanishme të zhvillimit, kërkon mbështetje institucionale sa i përket financimit të zhvillimit të tij, me qëllim të intensifikimit të zhvillimit ekonomik dhe uljen e nivelit të papunësisë stuktuore me të cilën aktualisht sot ballafaqohet Kosova.

Me aktivizimin e një pjese të mjeteve të lira buxhetore, do të dimanizohej oferta monetare dhe do të rritej kërkesa e brendshme e aggregatëve. Plasmanet e tillë do të rrisin potencialin kreditor të ndërmjetësuesve financiar, i cili në Kosovë, për momentin, është mjaft modest, duke patur parasysh strukturën e depozitave në dobi të atyre afatshkurtëra dhe në kohë shum të shkurtër – me muaj.

Sidoqoftë, efektet do të shprehen edhe në uljen e normës së interesit mbi plasmanet kreditore në përgjithësi në sistemin bankar të Kosovës duke u nivinizuar me ato që janë në regjion.

Vlenë të theksohet se niveli i arsyeshëm i normës së interesit do të ndikojë në rritjen e kërkesave për kredi të reja për financimin e zhvillimit të vendit.

Mënyra e tillë e financimit nga burimet vendore do të krijonte ambient të volitshëm për kreditime afatgjate për programe të caktuara zhvillimore ose në rast kur shteti duhet të participojë si partner në realizimin e programeve të caktuara në domenin e kompanive publike. Përkatësisht që në të ardhmen financimet e programeve zhvillimore e veçanërisht të atyre në fushën e agjencive publike të fitojë një dimension të ri duke nxitur zhvillimin më intensiv të vendit në kuadër të partneritetit të mirëfilltë.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, propozoj amendamentin, i cili ndryshon Ligjin nr. 2 të vitit 203 – Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, përkatësisht nenin 44 të këtij Ligji, duke ia shtuar paragrin 4. Citoj: “Neni 44.4 pavarësisht nga dispozitat tjera të nenit 44 Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund t’i japë hua një autoriteti publik nëse Qeveria dhe PSSP paraprakisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimin e asaj huaje.

Shpjegimi i huasë dhe mjetet nga interesi për këtë huadhënie do të derdhen në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës”.

Në fund, mendojmë se, duke u mbështetur në përparësitë dhe arsyeshmërinë e amendamentit të propozuar, kërkoj nga deputetët që ta miratojnë këtë amendament. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit zoti ministër. Para se të fillojmë shqyrtimin në parim të këtij Projektligji, theksoj se në sallë janë të pranishëm 78 deputetë, prandaj punimet janë të plotëfuqishme dhe çështjen e dytë, lus që të mbyllen telefonat celular dhe të mos kemi pengesa praktike në punë.

Sipas një praktike dhe duke u mbështetur në Rregulloren e punës, radha e diskutuesve do të jetë kësijoj: së pari do të dëgjonim përfaqësuesit e komisioneve, komisioneve funksionale dhe eventualisht komisioneve kryesore, nëse kanë diç të flasin për Projektligjin konkret.

Urdhëroni, kryetari i Komisionit të buxhetit, deputeti Haki Shatri.

### HAKI SHATRI:

Të falemnderit zoti kryesues, të rrespektuar kolegë deputetë,

Unë dola të flas lidhur me këtë pikë të rendit të ditës edhe si kryetar i Komisionit për buxhet edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ne këtë propozim për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e kemi shqyrtauar dhe qëndrimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është që ky ligj të përkrahet në leximin e parë. Dhe, mendoj që me këto ndryshime i hapet një hapësirë fushëveprimi institucioneve vendore që të bëjnë zgjidhje të nevojshme në fushën për të cilën zoti ministër veç prezentoi në fjalën hyrëse, edhepse, si ekspert i kësaj lëmie, në disa çështje kemi dilema rrëth konfrontimit të kësaj pike që po shtohet me ndonjë pikë tjeter. Por, mendoj se në procedimin e mëtejshëm, gjatë punës në komisione, këto dilema mund të mënjanohen dhe si i tillë, propozoj që nga deputetët e Kuvendit ky propozim të përkrahet dhe futet në procedurë për aprovim të mëtejshëm në Kuvend. Ju falemnderit.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Shatri. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Bajrush Xhemajli. E keni fjalën...

### BAJRUSH XHEMAJLI:

Kryesi e nderuar, kolegë deputetë,

Ju përshëndes në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Ne Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive e përkrahim në parim dhe nuk kisha shtuar shum në këtë drejtim, por e përkrahim për shkakun se fondet dhe mjetet e pashfrytëzuara të kenë mundësi të hyjnë në qarkullim dhe të racionalisohen ato mjete, të cilat, në të kundërtën, do të konservoheshin për muaj të tërë dhe nganjëherë, siç është bërë zakon te ne, të ketë suficit edhë në këtë gjendje siç jemi.

Unë pra nuk e kisha zgjatur më tutje, sepse u fol lidhur me këtë Projektligj që në fakt e ka një nen, e që ky nen është si shtesë i Ligjit që kemi aprovuar pak muaj më parë dhe mendoj se vetë fakti që e shtrojmë në këtë Parlament kaq shpejt, ende pa hy në punë Ligji i mëparshëm, do të thotë që nuk kemi kryer detyrën mirë.

Në anën tjetër, një nen e ka ky Projektligj por edhe këtu është mosharmonizim në aspektin gjuhësor, në tri gjuhët: anglisht, shqip dhe serbisht. Në qoftë se do të jetë ashtu "etnitet" siç është në gjuhën serbishte sigurisht se ne nuk do ta aprovojmë dhe që më parë po tërheqim vërejtjen, sepse nuk është e sqaruar. "Entitet" është fjala për një faktor ekonomik apo një, të them, një subjekt ekonomik si entitet, ndërsa si etnitet, n'ësë etnitetit i japim hu... do të thotë veçantë të një etniteti, që te ne mund të bëhen edhe këto gjëra, atëherë ne nuk do të jemi për këtë. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Koaliconit "Kthimi" Dragisha Kërstoviq, deputet.

#### DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo poslanici,

Zakon o menadžiranju javnih finansija, proglašen od Specijalnog Predstavnika Generalnog Sekretara, 12 maja 2003. godine što će reći da je tog dana stupio i na snagu i da se od tog dana primenjuje.

Mi, nažalost, nemamo ni dan danas prečišćeni tekst Zakona i jednostavno ne znamo kako izgleda taj zakon u prečišćenom tekstu i da li je ovo prilika da se raspravlja samo o amandmanu koji je Vlada predložila ili ovo može biti prilika i za podnošenje odnosno stavljanje u proceduru još nekih amandmana koji mogu da budu... koji bi mogli da poprave Zakon, za koji maločas jedan poslanik reče da – evo već za kratko vreme smo videli da zakonu nešto nedostaje i da on mora da se menja.

Bilo kako bilo, ja nemam načelnih primedbi drugih, osim ovoga, ali mislim da neće biti dovoljna... da neće biti dovoljan samo jedan član zakona da bi se ovaj Zakon popravi u ovom smislu u kom Vlada smatra da treba izvršiti popravku odnosno poboljšanje jer predloženi član 44. tačka 4. kaže: «Bez obzira na ostale odredbe ovog budžetske organizacije mogu da daju pozajmicu jednom određenom entitetu ako Vlada i SPGS se formalno slažu sa iznosom, uslovima i ciljevima te pozajmice». Ja očekujem da će funkcionalne komisije u poglavljju – definicije, morati da odrede koje su to ... šta se podrazumeva pod tim «određeni entiteti» kako bi se sprecile moguće zloupotrebe i moguće manipulacije ovim Zakonom. Znači, ako te odredbe nema u sadašnjem tekstu Zakona koji je usvojen i proglašen i koji se primenjuje, onda će komisije morati da, u svakom

slučaju, stave još jedan amandman na ponuđeni tekst Nacrta zakona o izmenama i dopunama ovoga Zakona.

S toga, mislim da bi, kada se pristupa ovakvim stvarima, moralo malo ozbiljnije da se to odradi.

I na kraju, hoću da stavim ozbiljnu primedbu na jezik koji je ministar upotrebio danas u ekspozeu. Zapravo, mislim da je jezik neprimeren i da nije dobro da se u ovom trenutku u ekspozeu govori: država ili ne znam bilo šta. Znam da će ovim da izazovem neke druge rasprave ali svejedno. Mislim da je obaveza predsedavajućeg da o upotrebi takvog neparlamentarnog jezika skrene pažnju. Hvala.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Besoj se i kemi t'qartë detyrat secili, në momentin ku gjendemi. Në emër të Aleancës, deputeti Bajram Kosumi dhe anëtar i Kryesisë, njëkohësisht.

#### BAJRAM KOSUMI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë,

Projektligji për menaxhimin e financave publike, krijon një raport të logjikshëm finansiar në mes Qeverisë së Kosovës dhe entiteteve publike. Grupi Parlamentar i Aleancës përkrahë në parim këtë Projektligj. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit zoti Kosumi. Për fjalë është paraqitur, anëtar i Kryesisë Oliver Ivanoviq.

#### OLIVER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege ministri,

U principu podržavam, znači u načelu podržavam izmene i dopune Zakona. Želeo bih samo da kažem jednu stvar. Danas smo mi čuli ekspoze ministra, ali s tog ekspozea meni nije bilo jasno zašto mi pravimo izmene i dopune Zakona. Jedina konkretna stvar u ekspozeu koju sam čuo to je član 44. stav 4. i

pridružiću se svima onima koji jažu da - ne mogu da verujem da nam je samo jedan stav u pitanju zbog čega menjamo zakon. Taj Zakon zaslužuje mnogo kritika i sigurno će biti mnogo izmena. Ubeđen sam da ćemo mi doprineti u odborima, svi zajedno, da se taj Zakon poboljša do takvog nivoa, da bude... da ostvari funkcionalno, kako vi kažete, menadžiranje javni prihodima. Znači funkcionalno upravljanje javnim prihodima.

Složiću se sa kolegom iz Alijanse koji kaže da – tako dobro smo obavili posao da nam je za tri meseca već trebalo da izvršimo izmene i dopune ovog Zakona.

Ja moram da kažem ono što sam već nekoliko rekao: ponekad olako prelazimo preko nekih stvari. Ponekad, u euforiji glasamo za zakon ili protiv zakona i šta ja znam i ostavimo stvari nedovršene. Počev od jezičkih stvari, jezičkih grešaka, koje nisu nevažne stvari jer su u prečišćenom tekstu po pravilu pojavljuju iste greške koje smo imali u ovome. Mi ne možemo računati da smo politički entitet koji je ozbiljan i odgovoran ako nam se ovakve stvari potkradaju. Zakon koji je usvojen, pogledajte sve zakone тамо, verujte za stručnjake, za pravnike koji se tim bave je prilično nerazumljiv. I ovaj Zakon spada u takve zakone, prilično nerazumljive zakone zbog svojih jezičkih formulacija.

Ja bih dodao samo da pitanje entiteta, to je rekao ... pitanje entitet, mi ga vezujemo uvek kao politički pojam, ali ovde se misli na pravni subjekt, znači na privredni subjekt. I to je razlog zašto treba da promenimo. Pitanje entiteta ovako kakvo sad stoji u Zakonu, ono izaziva određene nedoumice i ne bi to trebalo da tako ostane. Ja sugerisem da stručna služba, ako ne može da završi za 15 dana koliko odprilike je po meni normalan rok, neka jednostavno obavesti Skupštinu da nije spremna za tri nedelje, za četiri nedelje, ali mi računamo da ćemo nakon toga imati, rekao bih, kako se kaže jedan dobar uređen zakon, dobro ispisani zakon na koji ne bi smo imali više primedbi.

Znači, moja generalna primedba je, ministre, očekujem da nam tačno kažete – zašto ovaj Zakon tako brzo dolazi u fazu da se menja i to ne onim opisom koji ste dali, jer taj opis ste nam dali kada smo usvajali osnovno... znači osnovni zakon onda pre nekoliko meseci. Taj opis je isuviše uopšten, isuviše teoretski. Nama konkretno i meni kao poslanik konkretno treba da mi objasnите zašto, zar je samo član 44. stav 4. taj koji uzrokuje promenu odnosno ove izmene i dopune zakona. Hvala.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Për diskutim është paraqitur edhe një deputet dhe më vonë mund të kërkojmë eventualisht ndonjë sqarim nga ministrat. Mundem vetëm të them se paraprakisht në praktikën parlamentare është krejt e natyrshme të ndërrohen proceset, është koha, ekziston nevoja që të vazhdohet qoftë me ligje të reja në

tërësi, qoftë me ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve dhe s'është kurrfarë katastrofe. Nevoja themelore është që vërtetë të përgatisim dhe të miratojmë projekte si duhet. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

#### RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryesues, të nderuar deputetë dhe ministra,

Vërtetë ne sot kemi në rend pune Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi menaxhimin e finansave publike dhe të përgjegjësive. Natyrisht se në kuptimin juridik paraqitet arsyaja e domosdoshme që një ligj të plotësohet apo të ndryshohet. Por, në materialin që kemi marrë, ka munguar arsyetimi i bazuar rrëth këtij koncepti dhe rrëth kësaj ideje.

Unë personalisht dhe Grupi im, u muar vesh edhe të pranishmit këtu, përkrahim këtë Propozimndryshim të ligjit por, në rastin konkret, në mënyrën e plotësimit dhe të ndryshimit të ligjeve nuk është përcaktuar me Rregulloren e punës të Kuvendit apo me irregulloren e përkohshme. Megjithatë, procedura për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit është ajo që është edhe e miratimit të ligjit që nga fillimi. Mua në këtë rast, më shqetësojnë dy çështje, për të cilat do t'i jap vërejtjet parimore, me shpresë se ato do të inkorporohen në punën e mëtutjeshme.

Kur ligji kërkohet të ndryshohet, patjetër duhet të jipet një arsyetim i bazuar dhe dy: është jobindëse kërkesa e ndryshimplotësimit të Ligjit vetëm të një nen, gjegjësisht të një dispozite dhe atë për të lejuar organizatat buxhetore të japid hua kur për këtë merren vesh, kuptohet, dhe jipet pajtimi i plotë në mes Qeverisë dhe Përfaqësuesit Special të OKB. Sido që të jetë, duke analizuar këtë propozimligj për ndryshime mbi menaxhimin e finansave publike dhe përgjegjësive, unë paraqes këto kërkesa:

1. Propozimligjet në fjalë, i mungon arsyetimi që u dha me gojë, me rastin e informimit të deputetëve paraprakisht, për shkaqet dhe nevojat e arsyeshme;
2. Kush janë “etnitetet” dhe “entitetet”. Duhet të sqarohet në mënyrë juridike dhe çka është “subjekti ekonomik” dhe “subjekti juridik” që ne kur votojmë vërtetë të dijmë për çka po votojmë?
3. Cilat kushte duhet lplotësuar dhe çfarë afatesh dhe në cilat vlera mund të ndahen huatë?

4. Kur plotësohen kushtet dhe cilat janë format për marrjen e huasë me kamatë apo pa kamatë?
5. Për cilat sfera të veprimitarive mund të lejohen huatë?
6. Për cilat projekte mund të destinohet huaja?
7. Kush vendosë për dhënien e huasë?

Edhe pse këtu është dhënë në propozim qeveria, më falni Qeveria e Kosovës apo vullneti i Përfaqësuesit Special, por nëse vjen deri te mosmarrëveshja në mes tyre – a do të zbatohet ajo hua nëse ka arsyeshmëri të bazuar në kërkesë;

- Cila është procedura e dhënies së huasë dhe kthimi i saj?

Dhe, mbi të gjitha, dua ta them një të vërtetë që dihet shummirë për ata që kanë lexuar dhe krahasuar se propozimi për ndryshimligjin vjen ndesh me dispozitën e nenit 42, këtë e dijnë ata që e kanë lexuar dhe, në tërësi - edhe po të aprovohet, nuk mund të aplikohet. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Fjalën e ka Sadik Idrizi, nga koalicioni i grupeve tjera. Urdhëroni...

#### SADIK IDRIZI:

Samo kratko - da i druge zajednice podržavaju ovaj nacrt zakona odnosno predlog. Ako, oni koji primenjuju ovaj Zakon, su došli u situaciji da imaju problema, znaçí da je došlo do nekog zastoja u realizaciji, onda bi trebalo da se usvoji ovaj zakon. Drugo je što razlozi, znaçí trebali su da budu stvarno konkretno izneti ovde i šta..., koji su to problemi do kojih je došlo nakon primene od nekoliko meseci.

I kad sam izašao, samo još jedna stvar. Zakoni koji se usvajaju ovde u Skupštini i koji su potpisani, znaçí koji su na snazi, stupili na snagu – mi kao poslanici više sa stakvim zakonima, sa onim prerađenim, nemamo nikakvih kontakata.

Predlog je, da li je to u nekom periodu od 6 meseci ili kako, uradi znaçí zbirka proglašenih i potpisanih zakona da bi ih mi kao poslanici imali da bi znali šta smo usvojili jer često smo u bazi u situaciji dolje da nam ljudi traže zakone, da

pitaju za taj zakon i tako dalje, nismo... da ponudimo. Da li je to moguće ili ne, ali je kao predlog. Hvala.

**KRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Fjalën e ka Millovanoviq, urdhëroni edhe një herë! Në të vërtetë Milan Jovanoviq.

**MILAN JOVANOVIĆ:**

Hvala, još jednom gospodine predsedavajući. Poštovani poslanici, kolege i dragi ministri,

U načelu, ekonomsko gledano, niko nema pravo da neka... da kaže neka sredstva budu..., da neka sredstva finansijska budu imobilizirana, da se ne koriste, da se ne aktiviraju u privredi. Međutim, imajući u vidu činjenicu koju svi poznamo da dosta veliki broj građana Kosova i metohije radi u inostranstvu... Nema veze, i vi govorite Kosovo... radi u inostranstvu i da su dozname iz inostranstva prilično velike, međutim nisu ta sredstva s koncentrisana u bankarskom sistemu. Mene čudi da se sada ovde uvodi neki intervencionizam iz budžeta jer to nije praksa čini mi se u tržišnim privredama. To je neka vrsta opet one komandne privrede, neke socijalističke privrede pa me čudi da se to sada ovde putem ovog zakona pokušava da promoviše. Ja mislim da to nije dobro jer onda... izgleda da mi imamo veliki budžet i da smo ga prenapregnuli, to znači da smo nametnuli velike poreze i obaveze građanima... svim subjektima koji plačaju porez. Zašto su onda plate u javnom sektor male, zašto su plate nastavnicima male, koliko barem ja znam. Znam da su u Skupštini vrlo male, administraciji skupštinskoj. Ti ljudi onda imaju pravu da kažu – čekajte bre ako imate novac za tamo da ullažete u neke privredne projekte, to ne treba da ide iz budžeta. To treba da ide na sasvim drugačiji način. Prema tome, što se tiče «Trepče» i KEK-a naročito, tu se radi sigurno o velikim investicijama i ne znam kome je palo napamet da sada iz budžeta to servisira, te potrebe. Ja mislim da to najbolje da rade međunarodne organizacije, jer se tu radi sigurno o desetinama pa i više miliona eura u mislim da to nije ispravno i u tom smislu ja smatram da ovo nije ekonomski opravdano. Toliko. Hvala.

**KRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Ju falemnderit. Meqë diskutime më nuk kemi, ju lus.... Po ngrite dorën zotëri. Urdhëroni paraqituni me kohë...

### MUHAMET KELMENDI:

Unë as që pata, zonja e zotérinj, ndërmend të diskutoj sot sepse dakordohem me propozimet e grupeve parlamentare. Mirëpo, diskutimet tërheqin diskutimin dhe kjo është në natyrën e punës së Kuvendit. Në qoftë se na thuhet këtu, para kësaj bine se nuk qenka gjuhë parlamentare në qoftë se thuhet shteti i Kosovës dhe na qenka gjuhë parlamentare në qoftë se thuhet «Kosova i metohija» atëherë, natyrisht duhet të shtrojmë pyetjen – çfarë është dhe çfarë nuk është gjuhë parlamentare. Pikërisht gjuhë joparlamentare është të thuhet diçka që nuk ekziston në asnjëlloj dokumenti, qoftë të Rezolutës, qoftë të Kornizës dhe qoftë të ligjeve...

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Zoti Kelmendi, nëse keni konkretisht për ligjin, ju lutem.

### MUHAMET KELMENDI:

... ato janë, zotni krejtësisht manipulime të cilat bëhen. Sa i përket ligjit, përkrahu arsyimet që u thanë deri më tash dhe them se duhet në tërësi të heqet fjala «etnitet» dhe «entitet» dhe të zëvendësohet me subjektin, qoftë «subjekti ekonomik» qoftë «subjekti juridik». Me këtë, natyrisht bëhet zëvendësimi i tërësishëm dhe ligji do të marrë formën juridike. Ju falemnderit.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit. Meqë nuk ka diskutime tjera, lus ministrin Sadriu që të japë shpjegime plotësuese sipas adresimit konkret. E keni fjalën.

### ALI SADRIU:

Të falemnderit zoti kryesues. Në vërejtjen rreth «etnitetit» në terminologjinë ekonomike përdoret «etnitet ekonomik», por nuk ka kurgjë që të mirret dhe të zëvendësohet me subjekt për qëllime të qartësimit të funksionit përcaka shkruhet. Këtu u diskutua mjaft. Ligji disa muaj më parë është miratuar, tani po bëjmë ndryshim. Ligji edhe është hartaur para nja dy vite. Ka kaluar nëpër një odesiadë të tërë, sikur që e dini. Dhe, ajo odiseadë ka zgjatur këtu e në Nju Jork dhe u mbështjellë edhe këtu shumkohë. Pastaj, Ligji mbi menaxhimin e financave publike në Kosovë është i veçantë nga të gjitha ligjet tjera kudo në botë. Sepse, edhe vetë pozita e Kosovës dhe e udhëhejes edhe të çështjeve ekonomike e

buxhetore është e veçantë nga që kanë të tjerat. Ju e dini se në ndërkohë ka pasë disa bartje të përgjegjësive dhe ato përgjegjësi dalëngadalë do t'u japid fushëveprim institucioneve që të efektojnë aty ku mendojnë se e kanë vendin.

Me këtë dua t'ju parapërgatis sepse jam i bindur që ky Ligj edhe shumherë do të pëson ndërrime, dhe kam shpresën që ato të janë pozitive dhe jam i bindur se ato do të pasojnë.

Mendoj se arsyetimi është shum i qartë. Nuk kemi të bëjmë ne këtu me mjete, këtë e them për shkak të moskeqkuptimeve që u ngritën këtu: pse nuk trajtohen ato për shpenzime publike, ta zëmë – të pagave dhe tjera. Konsumi i Kosovës është në nivelin mbi të cilin nuk mund të shkohet. Megjithatë, rrethanat nën të cilat afaron Kosova, në veçanti, shpenzimet kapitale, investimet kapitale, kalojnë nëpër do procedura tepër – tepër të vështira. Rezultat i saj është edhe kjo seancë që e mbani këtu e jo në vendin ku e keni. Ajo është dashur të kryhet para një viti, zgjatin dhe ato mjete rrinë të bllokua dhe është qëllimi që gjatë kohës sa rrinë ato diku të afarojnë, të lëvizin, të mosmbesin të ngrime. Do të thotë, qëllimi fisnik i ndërrimit është shum i arsyeshëm dhe kam kënaqësinë që po e vërej pëlqimi ne të gjitha grupeve parlamentare dhe të tjerëve për një miratim të tillë.

Mendoj se gjatë shqyrimit, nëpër grupe punuese, mund të punohet përsëafërmimi me Ministrinë drejt finalizimit të këtij nenit, ashtu siç e mendojmë. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti ministër. Me këtë edhe mbyllim debatin rrëth Projektligjit në fjalë.

Thërras deputetët në sallë që të deklarohen:

Kush është për miratimin në parim të këtij Projektligji? Shumica është për.

A ka kush kundër? Dy.

A abstenon ndokush nga votimi? Shtatë.

Konstatoj se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike u miratua në parim dhe shkon në procedurë të mëtejshme; t'i përcillet komisioneve adekuate: Komisionit për ekonomi e financa; Komisionit për buxhet dhe Komisionit për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese që të hyjë në procedurë të mëtejshme.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For .....	Shumica – Vecina – Majority...
Kundër – Protiv – Against.....	02
Abstenime – Uzdrzanih – Abstained....	07

---

Në pikën e dytë të rendit të ditës, të tretë në fakt tash kemi:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për precticidet.

Ky Projektligj iu është shpërndarë deputetëve më 8 shtatorë 2003; janë përbushur të gjitha kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim, konform Rregullores së punës.

Sot këtu kemi prezent ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, zotri Goran Bogdanoviq, që so të paraqitet me ekspozenë e tij në emër të Qeverisë, përkatesisht të Ministrisë, pra që vjen nga ajo ministri dhe në emër të Qeverisë si sponzorues kryesor, dhe e lus që para deputetëve të paraqesë fjalën e tij. Urdhëroni, zoti Bogdanoviq.

**GORAN BOGDANOVIĆ:**

Poštovano Predsedništvo, poštovani poslanici,

Potreba za donošenje Zakona stoji u činjenici da oblast pesticida na Kosovu nije bila regulisana posebnim zakonom. Kada se ima u vidu činjenica da u poslednjih par godina na Kosovo se sve i svašta uvozi, a posebno u oblasti poljoprivrede tojest semenske robe i zaštitnih sredstava, Ministarstvo poljoprivrede i šumarstva i ruralnog razvoja je uzelo u sebi obavezu da doneše zakon o pesticidima gde bi, na neki način, pomogli individualnim poljoprivrednim proizvođačima da koliko-toliko reše taj problem sa hemikalijama koje upotrebljavaju u poljoprivrednoj proizvodnji.

Donošenje ovog Zakona takođe je neophodno iz razloga što smo pesticidi koji su bezbedni za zdravje ljudi, bilja i okolone mogu se proizvoditi, tojest uvoziti i upotrebiti na Kosovu i mogu se proizvoditi samo oni pesticidi koji su registrovani pri nadležnom organu radi proizvodnje i plasmana na tržiste.

Glavna pitanja koja regulišu ovaj Nacrt zakona su registracija pesticida, dozvola za trgovinu i proizvodnju i distribucija pesticida, zatim pesticidi koji su

zabranjeni i strogo ograničeni i izuzetno opasni po, naravno, zdravlje ljudi. Takođe autoritet za registraciju pesticida sprovođenje ovog zakona, naravno, prati i inspekcijski nadzor i naravno kaznene odredbe.

Odredbe ovog Nacrta zakona regulišu pitanje registracije pesticida i sertifikovanje sertifikaciju koju dobiju lica koja, naravno, podnesu zahtev za dobijanje dozvole za promet, proizvodnju, trgovinu i pakovanje pesticida. Samo registrovani pesticidi mogu se prizvoditi i stavljati u promet i ovom delatnošću mogu se baviti samo lica koja su prethodno dobila, znači sertifikat za proizvodnju, trgovinu to jest uvoz-izvoz i distribuciju pesticida.

Zabranjeni i strogo ograničeni izuzetno opasni pesticidi kao i hemikalije namenjene za proizvodnju pesticida sa potencijalom da prouzrokuju ozbiljne zdravstvene ekološke efekte, odredbama ovog Nacrta zakona ni u kom slučaju ne mogu se prizvoditi ili stavljati u promet. Ministarstvo će utvrđivati kategorije pesticida ove vrste. Autoritet za registraciju pesticida jeste autoritet pri Ministarstvu poljoprivrede, šumarstva i seoskog razvoja - nadležan za registraciju pesticida i licenciranju lica koje se bave proizvodnjom i trgovinom pesticida. Autoritet, pored ovoga, daje obaveštenja ministru o kontroli i upravljanja svim pesticidima na Kosovu. Formiranje ove agencije, imenovanje njihovih članova i ostala pitanja vezano sa radom autoriteta, takođe su regulisana odredbama ovog Nacrta zakona.

Sprovođenje ovog Nacrta zakona, inspekcijski nadzor, ovaj zakon reguliše na taj način što se propisuje nadležnost inspektora, kao što su pristup bilo kom zemljištu, pristup bilo kom objektu, pristup bilo kom prevoznom stredstvu ako se smatra ili postoji sumnja da se stavlja u promet ili prevozi, ili upotrebljava suprotno odredbama ovog Nacrta zakona. Znači, pravo je inspektora da preduzme sve radnje koje su propisane Nacrtom ovog zakona.

Kaznene odredbe ovog Nacrta zakona su predviđene kazne za svakog prekršioca radi podsticanja ispravnih postupaka u cilju ispoštovanja ovog Nacrta zakona.

Na kraju ću vam reći da u izradi ovog Nacrta zakona, pored stručnjaka u samom Ministarstvu učestvovali su naravno i međunarodni stručnjaci koji su angažovani u amom Ministarstvu i naravno lokalni stručnjaci ovde sa ovih prostora. Također, u izradi ovog zakona imali smo konsultacije sa predstavnicima UNMIK-a i smatramo da usvajanjem ovog Nacrta zakona da će se obezbediti uslovi za postizanje i održavanje odgovarajućih standarda i kvaliteta pesticidnih materija neophodnih za zaštitu života ljudi, biljaka i okoline. Hvala.

## KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

T'falemnderit zoti ministér. Sipas një rregulli, pra tē Rregullores së punës, fjalën pér Projektin që kemi në shqyrtim së pari do ta kenë komisionet, komisionet adekuate. Thërras përfaqësuesin e Komisionit pér bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural që tē japë mendimin lidhur me këtë. Urdhëroni. Deputeti Jusuf Sutaj.

## JUSUF SUTAJ:

Të nderuar deputetë, e nderuara Kryesi e punës, të nderuar ministra,

Ligji mbi pesticidet, është një ligj i cili rregullon një fushëveprimtari, e cila deri në këtë kohë nuk ishte e rregulluar, veprimtari e cila prej përfundimit të luftës e këndej ka qenë në një gjendje shumkaotike. Pesticidet, si substanca aktive pér shkatërrimin e insekteve ose dëmtuesve të bimëve njëkohësisht janë shum të rëndësishme, por në grupin e tyre, njëkohësisht, ka edhe elemente të cilat, po të mos menaxhohen me kujdes, janë shum të rrezikshme. Do tē thotë, mund tē krahasohen me elemente që shkaktojnë katastrofa ekologjike dhe katastrofa tjera shëndetësore dhe tē ndonjë natyre tjetër.

Ligji, në përgjithësi, është i përpiluar në mënyrë të mirë, një praktikë që Ministria e Bujqësisë e preferon që në kuadër të faqës të jenë tri kolona në të tri gjuhët, që kush i di gjuhët mund tē krahasojë. Ligji, në përgjithësi përfshin krejt gamën e veprimtarisë së manipulimit të importit, të eksportit, të shfrytëzimit të kategorive të ndryshme të pesticideve.

Në ligj, përveç ndonjë tē mete, tē interpretimit në mënyra tē ndryshme në gjuhë tē ndryshme, do tē thotë k u nuk përputhen në e sencë ato interpretime, por jo shumshpesh. Ndonjë e metë e veçantë e ligjit është se, në gjithstrukturën e ligjit diku përmenden 24 herë udhëzimet administrative, në kuadër të neneve dhe të paragrafeve, kuk pér tē njëjtën veprimtari tē neneve dhe paragrafeve ato jepen me nenin 19 si një formë e veçantë e udhëzimeve. Këtu duhet tē bëhet një korrigjim që, ose tē mbesin në kuadër të neneve, që aty nuk praktikohet fort, ose tē mbetet neni 19 si udhëzime administrative pér ligjin në përgjithësi.

Ne, në Komision, në parim jemi pajtuar që ky ligj tē marrë vizën, si ligj i rëndësishëm, një. Pér mbrojtjen e bimëve dhe manipulimi ose maneverimi me pesticidet tē jetë më i sigurt pér popullatën dhe njëkohësisht edhe Grupi Parlamentar i LDK, në parim mbështetë këtë ligj me përmirësimet që do tē bëhen, por nuk besoj se do tē ketë ndonjë përmirësim tē madh, përveç këtyre që i ceka. Ju falemnderit.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti Sutaj. Sipas kësaj, nëse s'kanë diç komisionet kryesore, fillojmë me grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, njëkohësisht ishte edhe përfaqësuesi i Komisinit. Lus përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike... Urdhëroni, zoti Luzha e ka fjalën.

### BERAT LUZHA:

Mund të themi se Propozimligji për pesticidet është hartuar dhe përgatitur mjaft mirë.

Kemi vëretejtje në gabimet drejtshkrimore që, megjithatë po i përcjellin thuaja çdo ligj deri më tash që vjen. Fillimi i ligjit është i mbushur me definicione të termave të ndryshme që përdoren në ligj dhe unë mendoj se është një praktikë e tepërt në ligje që po përdoret. Vetëm në këtë tekstu janë diku rreth 36 definicione. Shumica e tyre janë të panevojshme dhe të tepruara dhe madje edhe definicionet nuk janë aq shum adekuante.

Në ligj nuk saktësohet se cili atuoritet komunal jep licencat për barnatore, për ato të cilat shesin me pakicë, kurse licencat nuk do të duhej të lëshoheshin vetëm për 3 vjet por sigurisht se duhet të kenë një leje të qëndrueshme, me mundësi të suspendimit të lejes nëse ka vërejtje.

Një vërejtje tjeter në ligj mund t'i bëhet për afatin e përdorimit të pesticideve. Afati është hum i ngushtë, diku një vit. Mendoj se këtu duhet të përmirësohet dhe, sidoqoftë, ky Propozimligj nga ne përkrahet dhe duhet të shkojë në procedurë të rregullt në Kuvend.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit zoti Luzha. Në emër të Koalicionit «Kthimi» a dëshiron ndokush? Deputeti, Dragisha Kërstoviq.

### DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Poslanička grupa Koalicije «Povratak» nema načelnih primedbi na ovaj Nacrt zakona. Ono što je najvažnije, ustavni i pravni okvir za donošenje ovog zakona i nadležnost Skupštine nisu sporni. Znači ovo je oblast koju urežuju privremeni institucije samouprave. Naravno, očekujem da će nadležne komisije a naročito

Komisija za poljoprivrednu i ruralni razvoj imati pun doprinos na poboljšanju ovog zakona. Znači Poslanička grupa Koalicije «Povratak» u načelu podržava ovaj zakon i predlaže da zakon ide u dalju proceduru.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

T’falemnderit. Në emër të Aleancës, është paraqitur deputetja Sebahate Grajçevci. E lus ta marrë fjalën.

#### SEBAHATE GRAJÇEVCI:

Të nderuar deputetë, i nderuar kryesues,

Projektligji për pesticide, i sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës, është një projekt i punuar relativisht mirë. Projektligji për pesticidet trajton çështjet që kanë të bëjnë me prodhimin, shitjen, blerjen, importin, eksportin, paketimin, etiketimin e pesticideve si dhe çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin, licencimin, tregtimin, deponimin, qarkullimin, inspektimin dhe aplikimin e ndëshkimeve në rastin e shkeljes së dispozitave të ligjit.

Hartuesit i kanë patur parasysh kriteret ndërkombëtare lidhur me çfarëdo veprimi me pesticidet, prandaj ne duhet ta përkrahim në parim dhe të vazhdojmë trajtimin e tij në komisionet përkatësse, të cilat mendoj se, përveç intervenimeve kozmetike s’do të kenë shum punë në të.

Unë përgëzoj hartuesit e këtij Projektligji për punën që kanë bërë sepse vakumi ligjor për këtë çështje në vitet e fundit ka sjellë mjaft dëme në bujqësinë kosovare e ndoshta edhe në shëndetin tonë, nga se kanë qenë e mundur të hyjnë, të them figurativisht, në shtëpinë tonë me shum porta të hapura, produkte të dyshimta nga tregtarët e paliçencuar.

Prandaj, unë shpresoj se ky Projekt nuk do të zhagitet nëpër procedura, do të bëhet ligj sa më shpejt dhe do të zbatohet në kohën optimale. Ju falemnderit.

#### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Ju falemnderit zonja Grajçevci. Për diskutim, në emër të grupeve parlamentare të tjera, si është çështja? Urdhëroni, Hilmo Kandiq, deputet që përfaqëson grupet tjera.

## HILMO KANDIĆ:

Poštovani kolege, poštovano Predsedništvo, poštovani ministri,

Eto i ja samo da koristim priliku da u ime političke Parlamentare grupe iz redova ostalih i u ime Skupštinske komisije za poljoprivrednu, čiji sam ja član, dakle podržavam prvo razmatranje Nacrta zakona o pesticidima i predlažemo da ide u daljnju proceduru. Hvala.

## KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Falemnderit. Me këtë mbyllim diskutimin apo prezentimin nga ana e grupeve parlamentare. Për fjalë janë paraqitur edhe diskutues tjerë nga radha e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Blerim Baruti, le të përgatitet deputeti Ibush Jonuzi.

## BLERIM BARUTI:

Të falemnderit zoti kryesues. Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhdën e begatimit të legjislacionit të ri kosovar, po realizojmë shqyrtimin e parë të Projektligjit për pesticidet, si një ligj me rëndësi të veçantë që deri më tani i ka munguar Kosovës.

Duke u nisur nga fakti se pesticidet janë lëndë kimike që përdoren për t'u luftuar dhe asgjësuara dëmtuesit e bimëve e të kafshëve, që shkaktojnë sëmundje, në pesticide bëjnë pjesë: insektmbytësit, barvrasësit, këpurdhëvrasësit, rodeticidet, akrycidet e që në përgjithësi paraqesin helme për njeriun – për përdorim prodhohen lloje të ndryshme të pesticideve me prejardhje organike dhe inorganike, si iklorfenil, trikloreetani, sulfatnikotini, oksiklorurbakri, lindani, zinebi e shum e shum lloje të tjera.

Me anën e këtij ligji do të normohet një kornizë ligjore për import, eksport, tregtim, prodhim, paqetim, përdorim, deponim dhe ruajtje të pesticideve. Përshtypja e fituar, është se kemi të bëjmë me një ligj të strukturuar dhe të harmonizuar me ligjet e Unionit Evropian dhe të vendeve në rajon. Kontribut të çmuar në vlerësimet e tyre rrëth këtij Projektligji kanë dhënë shum ekspertë vendor e ndërkombëtar si dhe angazhim të palodhshëm ka treguar komisioni funksional.

Në bazë të kësaj që u tha dhe asaj të analizuar, konsideroj se Projektligji do të kalojë shqyrtimin e parë, sepse ka një gjuhë të akzeptueshme dhe një nivel të arsryeshmërisë.

Fare në fund, më mban shpresa se me vërejtjet, sygjerimet e plotësimet e atykëtushme, Projektligji do të begatohet deri në shqyrtimin e dytë, pra në fazën e amendamentimit, ashtu që ta marrë formën finale. Ju falemnderit në konsideratë.

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Të falemnderit zoti deputet. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

### IBUSH JONUZI:

Zoti kryesues, Kryesi e punës, ministra dhe deputetë të rrespektuar,

Mbështes diskutimet e mëparshme të deputetëve dhe ekspozënë e ministrit për bujqësi. Do të përpinqem që në fjalën time t'i jap disa plotësime që, mendoj, mund t'i shërbejnë Projektligjit në zbatim në praktikë dhe të jetë më funksional dhe më i sigurt gjatë përdorimit, rrespektivisht gjatë manipulimit me pesticide.

Karakteristikë kryesore e pesticideve është toksiciteti i tyre për çka, gjatë përdorimit të tyre, duhet të parashihen masa dhe mjete mbrojtëse adekuate. Për çdo pesticid, të dihet emri kimik, emri tregtar, të theksohet shkalla toksike, si dhe të bëhet përcaktimi i grupit të pesticideve në varshmëri nga shkalla e helmimit në mënyrë që me kohë të merren masa adekuate për përdorimin e mjeteve mbrojtëse; të p arashihet shkalla e kontaminimit, e cila karakterizohet nga koncentrimi i pesticidit në njësi vëllimore e cila shprehet më së shpeshti në gram/metër kub; përhapja e tyre mund të jetë edhe në gram/metër katror ose miligram/centimetër katror; pesticidet janë materie kimike me gjendje aggregate të ndryshme, do të thotë të ngurta, të lëngët ose të gaztë; përdorimi i tyre mund të shkaktojë shkallë të konsiderueshme të dëmtimit të organizmit të njeriut, shtazëve apo edhe bimëve. Prandaj, përdorimi i tyre, parashtron plotësimin e shumkërkësave paraprake për përdorim. Vendi në të cilin përdoren pesticidet përkohësisht janë vende të kontaminuara në varshmëri nga lloji i pesticidit dhe kushteve klimatike të cilat ekzistojnë në momentin e përdorimit të tyre dhe paraqesin rrezik për momentin e caktuar kohor.

Klasifikimi i pesticideve: Pesticidet në vete përbajnjë llojshmëri të komponimeve kimike, organike...

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Zoti Jonuzi, ju lus – nëse keni rrëth Projektligjit konkretisht, nëse keni vërejtje dhe qëndrimin tuaj. Pikërisht të mos zgjerohem i tepër dhe të keni kujdes.

### IBUSH JONUZI:

... Po, vetëm pak. Me veçori të ndryshme fiziko-kimike, po ashtu edhe efektet toksike në organizimin e njeriut, por është e nevojshme të ndahan në grupe. Domethënë, pesticidet e grupeve vdekjeprues; pesticidet e aftësimit të përkohshëm; sipas që ndrueshmërisë dhe ato të qëndrueshme, e të paqëndrueshme... U cek më herët se duhet të caktohet edhe afati i përdorimit, prandaj duhet me Projektligj të parashihen rrespektivisht me ligj... Veçori teknike e pesticideve është një prej vëçorive themelore që mund të shkaktojë lëndime të konsiderueshme, toksicidi mund të shprehet në shkallë lokale, lëndime të lëkurës, mukozës së hundës, organeve respiratore, organet e tretjes, ngacmime, skuqje, pulza, zvogëlimi i të pamurit, lotimi e tjerë. Efektet e përgjithshme të toksicideve paraqiten në...

### KRYESUESI FATMIR SEJDIU:

Zoti deputet, ju lus edhe një herë. Keni kujdes, përmbylleni diskutimin me qëndrimin tuaj rrëth Projektit në fjalë: është i mirë, ka çështje që duhet të shkojnë më tej, mund të miratohet në parim apo jo. ...

### IBUSH JONUZI:

... Në këtë mendoj se duhet të shtohen edhe disa çështje sa i përket, që thash edhe më herët, të përdorimit, mbrojtjes, mjetet gjatë funksionimit me pesticide që përdoren, mjetet mbrojtëse. Gjithashtu duhet të bëhet edhe aftësimi i kuadrove që punojnë me pesticide në mënyrë që të mos manipulon dikush që nuk është profesionalist i përgatitur.

Dhe së fundi, mendoj se është dashur të hyjnë edhe hebrividet në kuadër të Projektligjit për pesticidet dhe në parim e mbështes Projektligjin.

**KRYESUESI FATMIR SEJDIU:**

Ju falemnderit. Meqë për diskutim nuk ka të paraqitur të tjerë, mbyllim debatin.

Ju lus të deklaroheni: Kush është që Projektligji që është në shqyrtim të parë, të miratohet në parim.

Ju falemnderit. Është shumica.

Kush është kundër? Asnjë.

A ka ndonjë abstenim? Ju falemnderit.

Konstatoj se ky Projektligji u miratua në parim dhe të shkojë në procedurë të mëtejme.

Votmi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For ..... Të gjithë – Svi – All

Kundër – Protiv – Against ..... 00.....

Abstenime – Uzdrzanih – Abstained..... 00.....

Është, kujtoj, projektligj i parë që ka shkuar në këtë mënyrë. Ju falemnderit për këtë të gjithë deputetëve. T'i përcillet nga ana e Sekretarisë Komisionit për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural; Komisionit për gjyqësi dhe legjislacion dhe Komisionit për buxhet për procedurë të mëtejshme.

Ju falemnderit. Me këtë edhe shterrëm pikat e rendit të ditës për seancën e sotme. Ju falemnderit për prezencë. Besoj se me kohë do të informoheni, në bazë të vendimit që do ta marrë Kryesia, në koordinim edhe me grupet parlamentare, për vazhdimin në seancën tjeter edhe të rendit të ditës.

Ju falemnderit.

Seanca përfundoi punën në ora 11,30.

E transkriptoi RT(1-27) Zyra E-04, Tel: 211-860